



Planuar / Dorezuar Punjeve/Prodato Received/Delivery	05-10-2022	2	viti god year
Organ /Nesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	5903/2022		1/1



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.397/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malësore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.1888/2021 të datës 25.08.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën A.nr.397/2021 të datës 07.05.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi

kundër Njoftimit të datës 26.04.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës-shkelje e së drejtas së pagës dhe mundësi transferimi", duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 05.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.397/2021 e datës 07.05.2021 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi në datë 07.05.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 2272/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Njoftimit të datës 26.04.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave ligjore, shkeljeve procedurale dhe vlerësimit të gabuar, jo real dhe jo të plot të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 12.05.2021 ka procedura kërkesën për përgjigje në ankesë të Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës, ndërsa më datë 17.05.2021 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Këshilli në mungesë të kuorumit për vendosje përmes shkresës me numër protokoll 3488/2021 të datës 06.07.2021, ka njoftuar ankuesin lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës, duke udhëzuar të njëjtin lidhur me të drejtën e inicimit të konfliktit administrativ në gjykatën kompetente.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 25.08.2022 ka nxjerr Aktgjykimin A.nr.1888/2021 me të cilin ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të shqyrtoj dhe të vendos lidhur me ankesën e ankuesit A.nr.397/2021 të datës 07.05.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 2272/2021 të datës 07.05.2011 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 26.04.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 23.04.201 nga ankuesi për Drejtorin e Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës; Akt Emërimit e ankuesit i datës 31.05.2017 dhe 24.05.2018; Vendimin me Nr. Ref:12/2017 i datës 31.07.2017; E-mailin e datës 13.11.2017 nga _____ për ankuesin; E-mailin e datës 02.10.2017 nga _____ E-mailin e datës 06.09.2017 nga _____ E-mailin e datës 06.09.2017 ng; _____ Formularin për përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar i Administratës dhe Shpenzimeve i datës 12.04.2017; Diplomën e datës 15.12.2014 të ankuesit; Certifikatat në emër të ankuesit; Certifikatën e datës 06.11.2017; Certifikatën e datës 08.09.2017; Certifikatën e datës 20.04.2018; Listën e pagave për ankuesin; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 12.05.2021 dhe Përgjigjen në ankesë e datës 17.05.2021; Njoftimin e datës 06.07.2021 dhe Aktgjykimin A.nr.1888/2021 të datës 25.08.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, *është e bazuar, sepse:*

Sipas administrimit të shkresave të lëndës gjegjësisht Akt-it të Emërimit të datës 31.05.2017 ankuesi është emëruar në pozitën e punës "*Zyrtar për Administratë dhe Shpenzime*" me gradë të pagës AAC-5, ndërsa me Vendimin me Nr.Ref:12/2017 të datës 31.07.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të AAC-së i njëjti është caktuar që të ushtroj edhe detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrtarit të Pasurisë.

Me datë 23.04.2021 ankuesi parashtron kërkesë të Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës për ngritje të pagës dhe privilegjeve nga niveli AAC-5 në gradën AAC-4, ndërsa Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës (tutje AAC) më datë 26.04.2021 përmes shkresës mëme numër protokoll 2021/ZDP/143 ka njoftuar stafin e AAC-së së bazuar në Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe udhëzimeve të pranuar nga MPB, asnjë procedurë rekrutimi, lëvizje brenda kategorisë dhe ngritje në detyrë nuk mund të fillohet nëse pozita e cila plotësohet paraprakisht nuk është paraparë në organizimin e brendshëm të institucionit dhe nuk është siguruar buxhet për atë pozitë dhe së buxheti i ndarë për AAC-në për vitin 2021 lidhur me kategoritë e pagave dhe shtesave mbulon vetëm pozitë aktuale, kështu që kërkesat e stafit për rritje e pagave apo ngrije në detyrë nuk mund të trajtohen.



Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se i njëjti është diskriminuar pasi që nga viti 2017 nuk ka përfituar ngritje të pagës sikurse zyrtaret në departamentet tjera edhe pse ushtron edhe përgjegjësitë e Zyrtarit për Protokoll, Bibliotekë dhe Pasuri. Kërkon që Këshilli të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të obligoj Drejtorin e Përgjithshëm të AAC-së që të nxjerrë vendim për caktimin e gradës AAC-4 për ankuesin si dhe ti kompensoj në mënyrë retroaktive nga data 01.06.2017.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore Kolegji nga analizimi i provave të lëndës ka konstatuar së Autoriteti i Aviacionit Civil aplikon sistem të pagave të veçantë bazuar në aprovimet e Departamentit për Administrimin e Shërbimit Civil pranë Ministrisë së Administratës Publike sipas shkresave me numër reference DASC/MSHP Nr.71/LL& Rr.Z të datës 04.06.2009 dhe DASHC/MAP Nr.43/L.Z të datës 31.05.20210, ndërsa bazuar në konfirmimin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të AAC-së, rezulton së gradat e përcaktuara për këtë institucion janë nga AAC-1 deri në AAC-5, dhe rrjedhimisht grada AAC-5-875.00 është përcaktuar për pozitat: *Zyrtari Kryesor Financiar, Udhëheqësi i Njesisë se Burimeve Njerëzore, Udhëheqësi i Prokurimit, Zyrtarja Certifikuese, Zyrtari për Shpenzime dhe Administratë, Zyrtare Ekzekutive.*

Kolegji lidhur me shqyrtimin e themelësisë së pretendimeve ankimore ju referua nenit 19 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë më të cilin është përcaktuar se: *Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave*, si dhe nenit 9 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë më të cilin parashihet se: *Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara me aktin e kantatës së punës*, dhe rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në provat e lëndës Kolegji i Këshillit konstaton së ankuesi sipas Akt-it të Emërimit të datës 31.05.2017 lidhur me pozitën e punës "*Zyrtar për Administratë dhe Shpenzime*" ka të përcaktuar gardën e pagës AAC-5, dhe si njëjti po ashtu realizon pagën të përcaktuar sipas kategorisë funksionale-Grada AAC-5 .

Po ashtu në funksion të ligjshmërisë së pretendimit ankimor të ankuesit për ngritje të gradës së pagës nga AAC-5 në AAC-4, Kolegji i Këshillit për vendosje meritore të kësaj çështje juridike ka analizuar edhe nenin 7 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë me të cilin është përcaktuar se: *1.Udhëheqësit e institucioneve të administratës publike ia propozojnë gradat e pozitive në institucionin e tyre ministrisë përgjegjëse për administratë publike, në bazë të rekomandimeve të personit përgjegjës për burime njerëzore në institucionin e tyre, i cili është përgjegjës për zbatimin e standardeve dhe procedurave për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil. 2. Grada për secilin pozicion të punës dhe ndryshimet, miratohen nga Qeveria, me propozim të institucionit përkatës dhe aprovimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financat...* si dhe Ligjin Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi përkatësisht nenin 4 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *Diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji*, andaj, nisur nga kjo bazë ligjore dhe duke qenë së ankuesi realizon gradën e pagës sipas Akti të Emërimit, Kolegji nuk vëren rrethana të trajtimit jo të barabartë dhe diskriminues të ankuesit në raport me zyrtaret tjerë, kështu që mbi bazën e këtyre konstatimeve rrjedhë së janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesit për ngritje të gradës së pagës dhe kompensimin retroaktiv nga data 01.06.2017.

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.397/2021

Avdyl BEKTESHI

[Signature]
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhiqaj-Demi

[Signature]
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

